

## AKT – THEMELIMI

### **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR PUZZLE PRODUCTION & DISTRIBUTION**

Bazuar në ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me vullnetin e saj të lirë, të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më date 12 mars 2019 themeluesja :

Labeata Ramizi e datelindjes 28.05.1986 lindur ne Shkoder, banuese ne Shkup (Maqedonia e Veriut) shtetase shqiptare me numer personal I65528068J dhe mbajttese e ID 029307723.

#### **Deklaron se:**

ka vendosur të nënshkruajnë këtë Kontratë Themelimi, për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar “PUZZLE PRODUCTION & DISTRIBUTION” (Shpk), më poshtë referuar “Shoqëria”.

Veprimtaria e Shoqërisë do të rregullohet nga Akti i Themelimit, Statuti i shoqërisë dhe legjislacioni shqiptar për shoqëritë tregtare.

#### **Neni 1 – Emërtimi**

Shoqëria emërtohet ““PUZZLE PRODUCTION & DISTRIBUTION”.  
Emërtimi mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose të vogla.

#### **Neni 2 – Selia**

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në adresen: Rruga Ali Demi, Pallati 156, Hyrja 2, Apartamenti 6, Tirane.

#### **Neni 3 – Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Ortakeve.

#### **Neni 4 – Objekti**

Objekti i Shoqërisë është si më poshtë:

Prodhimi dhe shperndarja ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj te filmave artistike te metrazhit te gjate, te mesem dhe te shkurter, te dokumentareve, te filmave vizatimore, filmave publicitare dhe te programeve audio-vizuale ne te gjitha format ekzistuese ; organizimi i aktiviteteve kinematografike, artistike, audio-vizuale te cdo lloji ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj; dublimi .subtitrimi i filmave te huaj dhe i filmave shqiptare per vendet e tjere; prodhimi dhe shperndarja e te gjitha spektakleve artistike te skenes dhe te televizionit ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj; dhenia e asistences teknike .artistike dhe organizative te nevojshme per prodhimin e filmave



artistike te metrazhit te gjate, te mesem e te shkurter ,te dokumentareve,te filmave vizatimore, filmave publicitare dhe te programeve audiovizuale ( perfshire skenen dhe televizionin ), qe do te prodhohen ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj, ne pergjithesi kryerja e cdo aktiviteti tjeter ,qe shoqeria do ta konsideroje te arsyeshme.

#### **Neni 5 – Kapitali themeltar i shoqerise**

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100.000 lekë (njqind mije). Ortaku themelues Labeta Ramizi është zoteruese e 1 (një) kuote me vlerë te pergjithshme 100.000 lekë qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqërisë. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

#### **Neni 6 – Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit**

Zotërimi i kuotave, mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave, pjestimi dhe transferimi i tyre do të bëhen sipas procedurave të parashikuara në ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe nga Statuti i Shoqërisë.

#### **Neni 7 – Administrimi**

Administratori i Shoqërisë është Labeta Ramizi e cila do te qendroje ne detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhjeje.

#### **Neni 8- Vula**

Shoqeria ka vulen e vete me permbajtje “PUZZLE PRODUCTION & DISTRIBUTION”

#### **Neni 9 – Të tjera**

Shoqëria do ta ushtrojë veprimtarinë e saj sipas legjislacionit shqiptar. Kushtet e punës, shpërblimet, oraret, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose ajo individuale e punës, si dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

#### **Neni 10**

Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet, që mund të lindin, gjatë ushtrimit te aktivitetit të Shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj, midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarve për t’ i zgjidhur miqësisht. Në rast të kundërt i nënshtrohen juriksionit të gjykatave kopetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

#### **Neni 11**

Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje me vlere te njejte juridike.

### **ORTAKE THEMELUESE**

**Labeta RAMIZI**

